



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:185273

Datë: 22.02.2021

Numri i dokumentit: 01526843

**PKR.nr.243/2020**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda**, kryetari i trupit gjykues Shaqir Zika, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë e kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit B. (M.) K. nga fshati . . ., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.171/2020, të datës 30.12.2020, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 12.02.2021, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të njëjtën ditë muar dhe publikisht shpalli, ndërsa **me datën 22.02.2021** përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari:

**B. K.**, i biri i **M.**, e ëma **N.** e gjinisë **Sh.**, data e lindjes . . ., tani me vendbanim në fshati . . . K- Malisheve, i pa martuar, ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

## Ë S H T Ë F A J T O R

**Më parë** ka siguruar dhe gjerë me datën 15.12.2020, rreth orës 18:55 minuta në fshatin . . ., komuna e Malishevës, pikërisht tek ura e . . .it, pa autorizim ka poseduar armë dhe municionit në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për armët e Republikës së Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara, dhe atë një pushkë gjuetie dy tytëshe të markës “Cifsan Tufeklleri” prodhim Turk, me numër serik152466, e kalibrit 12 mm, dhe 20 (njëzet) fishekë të kalibrit të njëjtë, në atë mënyrë që ditën kritike gjatë ndalimit dhe kontrollës nga zyrtarë policor të Stacionit Policor në Malishevë, të automjetit të. Markës “kamioner . . .”, me targa të regjistrimit . . . të cilin e drejtonte **G. Z.**, me të cilin i pandehuri si pasagjer ishte i ulur pikërisht në pjesën e pasme të brendshme të automjetit ku është gjetur dhe sekuestruar me armë dhe municioni i lartcekur të cilën i pandehuri paraprakisht e kishte marr në shtëpinë e tij.

Me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPP-së të akuzuarin e:

## G J Y K O N

**ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej pesëqind (500) €uro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëzetepesë (25) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga njëzet (20) €uro.

Ndaj të akuzuarit konfiskohet: një (1) pushkë gjuetie dy tytëshe të markës “Cifsan Tufeklleri” prodhim Turk, me numër serik152466, e kalibrit 12 mm, dhe 20 (njëzet) fishekë të kalibrit të njëjtë, si objekt i veprës penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo armë dhe municion duhet të shkartohet nga policia e Kosovës, me bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Gjakovë, pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

**Detyrohet** i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej pesëdhjetë (50) €uro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) €uro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.171/2020, të datës 30.12.2020, ndaj të akuzuarit B. K. nga fshati . . .ë, Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 12.02.2021, në të cilin kanë marr pjesë Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala si dhe i akuzuari B. K..

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari B. K., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet me aktakuzë dhe ka shtuar se pendohem thellë për veprën e kryer, pushkën e gjuetisë e kam marrë nga shtëpia pa lejen e prindërve, kam dalë me shokë në gjueti, mirëpo gjatë rrugës më ka takuar policia dhe në automjet ku kam qenë i ulur e kam pasur armën e cila më është konfiskuar, andaj i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë të paraparë me ligj, dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtitilla.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaron se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë pasi që i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije të plotë dhe ky pranim

ka mbështetje edhe në provat të cilat është mbështetur aktakuza e të cilat janë pjesë të shkresave të lëndës dhe i propozojë gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovoj.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari B. K., me dashje ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

## 5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarin B. K. e ka shpallur fajtor për veprën penale ngase në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij

## 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është i moshës së re, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale si dhe gjendjen e tij ekonomike, kështu që duke mos gjetur rrethana renduese ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar me gjobe si në dispozitiv të këtij aktgjykimit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi mbi konfiskimin e armës

Duke u bazuar në nenin 366 paragrafi 3 të KPRK, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që ndaj të akuzuarit të konfiskohen pjesët e armëve dhe municionit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si objekte të veprës penal.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së si dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari trupi gjykues ka vendosur që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti për Krime të Rënda -**  
**PKR.nr.243/2020, të datës 22.02.2021**

**Procesmbajtësja,**  
**Nushe Kadrija**

**Kryetari i trupit gjykues,**  
**Shaqir Zika**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.